AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 3/N3-14 **Prot.**
Nr. Dok.202500181/14

Tiranë 18/5 **/2026**

Lënda : *Rekomandim për marrjen e masave administrative dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për zgjidhjen e shqetësimit të shtetasit Novruz Bega lidhur me aksesin dhe lidhjen me rrjetin e kanalizimeve.*

Drejtuar: **Bashkia**

SARANDË

Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizimeve sha

SARANDË

Për dijeni: **Novruz Bega**
Lagjja nr. 3, Cel: 0692790167

SARANDË

Të nderuar!

Institucioni i Avokatit të Popullit, në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike, ka pranuar për shqyrtim ankesën e shtetasit Novruz Bega, banor i Qytetit të Sarandës, i cili ankohet ndaj Bashkisë Sarandë, dhe Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizime sha, Sarandë, për mosveprim në zgjidhjen e çështjes, të ndërtimit të tubacionit të shkarkimit të ujrave në një sipërfaqe toke të ndodhur në kufi me banesën e tij, e cila është e rrethuar dhe në posedim të një tjetër shtetasi.

Institucioni i Avokatit të Popullit në kushtet e dyshimit të shkeljes të së drejtës së ankuesit për akses efektiv në shërbime publike bazë (kanalizime), ka pranuar për shqyrtim çështjen.

Me rastin e pranimit për shqyrtim të çështjes, i është kërkuar Bashkisë Sarandë dhe Shoqërisë "Ujësjellës-Kanalizime" sha, Sarandë, me anë të shkresës nr. K3/N9-2 prot, datë 10.11.2023, informacion dhe shpjegime lidhur me:

- Informacion nëse ankesi ka kryer kërkesë për ndërtimin e kanalizimit (vendosjen e tubacioneve për shkarkim) të ujrave të zeza e të bardha nga banesa e tij për rrjetin e kanalizimeve që administron UK sh.a. Sarandë. Nëse po, cila është përgjigja e dhënë ankuesit?
- Në kushtet kur ankuesi shprehet se disponon dokumentacion pronësie mbi banesën e tij, kërkojmë të informohemi rreth zgjidhjes së dhënë për shkarkimin e ujrave nga banesa për në rrjet, referuar dokumentacionit për ndërtim të nxjerrë prej organit përkatës. Vënien në dispozicion të këtij dokumentacioni.
- Cilat janë mundësitë për zgjidhjen e shqetësimit të ankuesit sa më parë e mundur? A ekzistojnë pengesa objektive për zgjidhjen e çështjes së ankuesit dhe nëse po, cilat janë ato?
- Çdo informacion tjetër që lidhet me çështjen e prezantuar.

Në përgjigje të kërkesës, Shoqëria "Ujësjellës-Kanalizime" sha, Sarandë, me shkresën nr. 612/1 prot, datë 20.11.2023, bën me dije Avokatit të Popullit, se:

"... "Shoqëria Rajonale "Ujësjellës-Kanalizime Sarandë" sha, i është drejtuar Bashkisë Sarandë, Zyrës së Urbanistikës, me kërkesë për vënien në dispozicion studimin urbanistik si dhe pronësinë që ka Bashkia për këtë zonë, për të mundësuar zgjidhjen e ankuesit, z. Novruz Bega".

Në kushtet e mosdhënies së informacionit dhe shpjegimeve prej Bashkisë Sarandë, ju jemi ridrejtuar me anë të shkresave nr. K3/N9-4 prot, datë 09.02.2024 dhe nr. K3/N9-5 prot, datë 01.07.2024. Në përgjigje të kërkesës së përsëritur, Bashkia Sarandë, me shkresën nr. 3840/1 prot, datë 25.07.2024, bën me dije, se:

"... Bashkia Sarandë, me shkresën nr. 5314/1 prot, datë 14.12.2023, dhe shkresën nr. 5741/1 prot, datë 29.02.2024, i është përgjigjur Shoqërisë "Ujësjellës-Kanalizime Sarandë" sha, duke i vënë në dispozicion fragment nga Njësia Strukturore SAUB. 4.40/1 si dhe informacion me situatën e pronësisë së Bashkisë Sarandë.

Bashkëlidhur ju vëmë në dispozicion kopje të shkresave të sipërpërmendura".

Për këtë situatë të prezantuar, prej Bashkisë Sarandë, është informuar Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë" sha, me anë të shkresës nr. K3/N9-7 prot, datë 22.05.2024. Në përgjigje të qëndrimit të shprehur prej Bashkisë Sarandë, Shoqëria Rajonale "Ujësjellës-Kanalizime Sarandë" sha, me shkresën nr. 391/1 prot, datë 16.06.2025, drejtuar Avokatit të Popullit, shprehet, se:

"...Fragmenti nga Njësia strukturore SAUB 4.40/1 sipas PPVB Sarandë, miratuar me vendim të Komisionit Kombëtar Teknik nr. 3, datë 16.10.2017, i ndryshuar, të vënë në dispozicion nga Bashkia Sarandë, nuk ka gjë të qartë lidhur me kufijtë e pronësisë së dy qytetarëve që janë në konflikt për kufijtë ndarës të pronësisë së gjithësecilit.

Në këto kushte, Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë" sha, nuk mundet që të prishë rrethimet e pronave, duke qenë se është ndërmarrje e specializuar për furnizimin me ujë dhe largimin e ujrave të ndotura dhe jo atë të kufirit të pronave.

Për këtë arsye sugjerojmë që Bashkia Sarandë, e cila disponon të gjitha mjetet, duhet të marrë masa për prishjen e rrethimeve në qoftë se janë të paligjshme.

...

Pasi të vendos kufijtë, ne si Shoqëri jemi të disponueshëm të realizojmë lidhjen e qytetarit me rrjetin e largimit të ujrave të ndotura".

Referuar qëndrimit/deklarimeve të Shoqërisë Rajonale "Ujësjellës-Kanalizime Sarandë" sha, është kërkuar me anë të shkresave nr. K3/N9-9 prot, datë 27.06.2025, nr. K3/N10- prot, datë 30.07.2025, nr. K3/N11- prot, datë 13.10.2025, dhe nr. K3/N12- prot, datë 04.12.2025:

- Informim rreth mundësisë së Bashkisë, Sarandë, IMT-së pranë saj, Policisë Bashkiake, Sarandë, për mbështetje dhe bashkëpunim me UK, Sarandë, në zgjidhjen e çështjes së shtetasit Novruz Bega;

- Informim nëse ekzistojnë pengesa për mbështetjen, bashkëpunimin me UK, Sarandë, në zgjidhjen e çështjes së shtetasit Novruz Bega.

Për këtë kërkesë, pa shkak të bërë të ditur, Bashkia Sarandë, nuk ka dhënë informacion, qëndrim i cili vjen ndesh me nenin 63, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, se:

"Organet dhe funksionarët publik janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij",

nenin 19, pika "b", të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 *"Për Avokatin e Popullit"*, të ndryshuar, se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga cdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë cdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin".*

Nga shqyrtimi i ankesës së paraqitur nga shtetasi Novruz Bega si dhe nga komunikimet zyrtare të zhvilluara me Bashkinë Sarandë, dhe Shoqërinë Rajonale "Ujësjellës-Kanalizime Sarandë" sh.a., rezulton se ankuesi ka ngritur shqetësimin lidhur me:

• pamundësinë për vendosjen e tubacioneve të ujërave të bardha dhe të zeza për lidhjen e banesës së tij me rrjetin publik të kanalizimeve që administrohet nga Shoqëria Rajonale "UK Sarandë" sha;

• mungesën e ndërhyrjes dhe të bashkëpunimit institucional nga ana e Bashkisë Sarandë, për sqarimin e kufijve të pronësisë dhe ligjshmërisë së rrethimeve ekzistuese. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se Shoqëria Rajonale "UK Sarandë" sha ka shprehur gatishmërinë për realizimin e lidhjes me rrjetin publik, por ka theksuar se kjo nuk mund të kryhet pa sqarimin e statusit juridik të sipërfaqes përkatëse të tokës dhe pa ndërhyrjen e organit kompetent vendor;

Pra, mungesa e aksesit nga ana e ankuesit nuk është zgjidhje e tij, por pasojë e mosveprimit administrativ.

Në këtë situatë të çështjes, Institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson se:

1. Shoqëria "Ujësjellës–Kanalizime" sh.a. ka vepruar brenda kompetencave ligjore, pasi nuk ka tagër për të përcaktuar kufij pronësie, për të prishur rrethime apo për të zgjidhur mosmarrëveshje civile mes subjekteve private.

2. Bashkia Sarandë, në cilësinë e organit kompetent për administrimin e territorit, urbanistikën, kontrollin e ndërtimeve dhe dhënien e informacionit publik ka detyrimet si vijon:

• ka detyrim ligjor për të dhënë informacion të plotë, të qartë dhe të kuptueshëm;

• ka detyrim për të ushtruar kompetencat e saj për verifikimin e ligjshmërisë së rrethimeve dhe përcaktimin e kufijve sipas dokumentacionit urbanistik;

• duhet të sigurojë bashkëpunim efektiv ndërinstitucional për garantimin e aksesit të qytetarëve në shërbime publike bazë. Moskthimi i përgjigjeve të kërkuara dhe mungesa e veprimeve konkrete përbëjnë mosveprim administrativ, në kundërshtim me parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe shërbimit ndaj qytetarit.

Mosveprimi i Bashkisë Sarandë, ka sjellë për ankuesin pamundësinë e tij për t'u lidhur me rrjetin publik të kanalizimeve; cenimin e të drejtës për banim dinjitoz dhe përdorim normal të banesës; cenimin e jetës private dhe familjare; krijimin e pasigurie juridike dhe barrë disproporcionale mbi të, si dhe zvarritje të pajustifikuar në kohë të ushtrimit të të drejtave të tij.

Pra, kjo çështje nuk është thjesht administrative, por prek thelbin e disa të drejtave bazë. Mosveprimi i vazhdueshëm i Bashkisë Sarandë, është tregues i dështimit në veprimtarinë e saj, është tregues i bllokimit të bashkëpunimit institucional. Po ashtu, tejzgjatja e moszgjidhjes së problematikës së qytetarit ka cenuar në thelb të drejtat e tij. Efekti real në jetën e përditshme të ankuesit eshtë pamundësia e tij për përdorimin normal të banesës, cenim i jetës private dhe familjare, ndikimi i drejtpërdrejtë dhe i vazhdueshëm në jetën ankuesit dhe familjes së tij.

Ndërhyrja e Avokatit të Popullit justifikohet pasi çështja nuk përbën vetëm një mosmarrëveshje civile ndërmjet subjekteve private, por është kthyer në një problem të qeverisjes publike, si pasojë e mosveprimit dhe mungesës së bashkëpunimit institucional nga ana e Bashkisë Sarandë, si autoritet vendor kompetent. Ky mosveprim ka penguar ushtrimin e kompetencave ligjore të një organi publik/enti tjetër dhe ka prodhuar cenim të vazhdueshëm të të drejtave të ankuesit.

Më tej, duke u fokusuar në njohjen e standardeve ndërkombëtare, theksojmë faktin se Rezoluta 64/292 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, njeh të drejtën për ujë të pijshëm dhe kanalizime të sigurta dhe të pastërta, si një e drejtë e njeriut' që është thelbësore për gëzimin e plotë të të gjitha të drejtave. Asambleja e Përgjithshme[1] u bën thirrje Shteteve dhe organizatave ndërkombëtare që të ofrojnë burime financiare, ngritje kapacitetesh dhe transferim teknologjie, nëpërmjet ndihmës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht për

[1] https://digitallibrary.un.org/record/687002?ln=en

vendet në zhvillim, në mënyrë që të shtojnë përpjekjet për të siguruar ujë të pijshëm dhe kanalizime të sigurta, të pastërta, të aksesueshme për të gjithë.

Shqipëria është një nga vendet që ka nënshkruar Deklaratën e Mjëvjeçarit duke u angazhuar në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit deri në vitin 2015. Dhe në shtatëmbëdhjetë Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ), të cilat kanë si afat vitin 2030 . Në këtë axhendë të re të zhvillimit, uji dhe kanalizimet konsiderohen të kenë rol kyç në të gjitha dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm, për sa ato kanë lidhje me disa probleme kryesore globale dhe kanë ndikim në të gjitha aktivitetet njerëzore.

Ndër të tjera, për herë të parë në historinë e saj, Kombet e Bashkuara kanë pranuar se kushdo, kudo, ka të drejtë të jetojë në një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm[2]. Rezolutat nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut në 2021 (A/HRC/RES/48/13) dhe Asambleja e Përgjithshme në 2022 (A/RES/76/300) e shtojnë këtë të drejtë themelore të njeriut në bibliotekën e të drejtave të njohura ndërkombëtarisht.

Po ashtu, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e ka parashikuar të drejtën e një mjedisi, "*për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm*"[3] si synim të objektivave sociale dhe përgjegjësi të shtetit, brenda kompetencave të tij.

Në këtë drejtim, shëndeti i njeriut mund të shihet si urë domethënëse midis të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së mjedisit, duke qenë objektivi parësor i të dy fushave të rregullimit. Të drejtat e njeriut ekzistojnë për të promovuar dhe mbrojtur mirëqenien njerëzore, për të lejuar zhvillimin e plotë të secilit person dhe maksimizimin e qëllimeve dhe interesave të personit, individualisht dhe në bashkësi me të tjerët. Parakusht për shëndetin janë mjedise të sigurta, p.sh ajri, uji dhe toka. Ndotja ndikon në klimë, e cila nga ana tjetër fillon me një sërë reagimesh që rezultojnë në fatkeqësi natyrore. Ai shkatërron shëndetin dhe vret, kështu që jo vetëm që shkatërron mjedisin, por shkel edhe të drejtat e njeriut.

Duke e trajtuar këtë çështje në një këndvështrim më specifik, evidentojmë se ju si organe kompetente, ushtroni në përputhje me legjislacionin në fuqi, funksionet dhe kompetencat tuaja. Në cilësinë e organeve përgjegjëse për shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes, keni lirinë dhe autoritetin e marrjes së vendimeve si dhe përdorimit të mjeteve për këtë qëllim, brenda hapësirës së normave, kritereve dhe standardeve të pranuara përgjithësisht me ligj, duke zotëruar autoritet të plotë administrativ, për të kryer shërbime, investime dhe rregullime.

Një ndër funksionet e veta të Bashkisë Sarandë, në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në përputhje me përcaktimin e dhënë në nenin 23, të ligjit nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, të ndryshuar, është: *"...bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm, mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara..."*

[2] https://www.ohchr.org/en/special-procedures/sr-environment
[3] Neni 59, paragrafi 1, pika (d) e Kushtetutës

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mbështeten në veprimtarinë e tyre të përditshme pikërisht në konceptin e *autonomisë vendore*, të kuptuar si, *"... e drejta dhe aftësia e njësive të qeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë"*, siç parashikohet në nenin 2/2, të ligjit nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*.

Një rol të rëndësishëm në ushtrimin e kompetencave për ndërtimin/mirëmbajtjen e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre, luan edhe Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë, sha, e cila ka si mision të punës së saj, përmirësimin e menaxhimit në Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në atë zonë, për ta bërë atë më efiçent, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit, vlerëson se Bashkia Sarandë, nëpërmjet Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë sha, është autoriteti përgjegjës për trajtimin e ujërave të ndotura në zonën ku ka vendbanimin ankuesi.

Sipas VKM-së nr. 1304, datë 11.12.2009 *"Për miratimin e modelit të Rregullores "Për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizime sh.a""*, përcaktohet qartë se Bashkia, ngarkon për funksionim dhe mirëmbajtje një shoqëri publike të licensuar nga Enti Rregullator Kombëtar i Ujit për shërbimet e ujësjellës kanalizimeve. Bashkia Sarandë, që posedon 100% aksione të kësaj shoqërie, me anë të asamblesë së aksionarëve realizon vendimmarrjet e rëndësishme për Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë, sha, përcakton natyrën dhe qëllimin e shoqërisë si edhe datën e zbatimit, zgjerimin ose riorganizimin e saj.

Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sarandë, sha përfaqëson entin funksional dhe ekzekutiv që vepron në emër të Bashkisë Sarandë dhe që ka detyrimet dhe përgjegjësitë publike për shërbimet e furnizimin me ujë dhe të kanalizimeve të ujërave të ndotura në qytetit.

Pra, të gjitha këto akte ligjore dhe nënligjore kërkojnë dhe kanë si kusht ushtrimin e detyrave tuaja funksionale dhe marrjen e masave të menjëhershme për zgjidhjen afatgjatë të problemit të ujërave të ndotura jo vetëm për rastin e ankuesit Novruz Bega, në përputhje me standardet e kërkuara dhe si një nevojë emergjente për të mos cenuar në asnjë rast shëndetin e qytetarëve të zonës.

Për sa më sipër, nga informacioni i prezantuar për këtë çështje del e qartë se, banesa e ankuesit, ndodhet në mungesë të infrastrukturës për mbledhjen/largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

Në analizë të fakteve të mësipërme, institucioni i Avokatit të Popullit synon që jo vetëm të vërë në lëvizje organet kompetente, por dhe t`i sensibilizojë ato për vetë rëndësinë që ka kjo problematikë, ndaj, ne theksojmë marrjen e veprimeve konkrete për zgjidhjen përfundimtare

të problemit të ankuesit, sikundër është menaxhimi i ujërave të ndotura të cilat kanë ndikime negative në ekosistem dhe turizëm.

Në këtë kuadër, duke pasur parasysh se kjo është një çështje e rëndësishme për qytetarët, të cilëve duhet ti garantohet e drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe kanalizime. Avokati i Popullit dëshiron të sjellë në vëmendjen tuaj ushtrimin e detyrave funksionale dhe marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e situatës së krijuar përmes investimeve në infrastrukturën e kanalizimeve në zonën përreth banesës së ankuesit.

Në ushtrim të detyrës për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, si dhe nxitjes së standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në parashikimet e ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999, *"Për Avokatin e Popullit"*, të ndryshuar, ligjin nr. 139/2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"*, të ndryshuar, gjen me vend të adresojë pranë Bashkisë Sarandë, dhe Shoqëria Rajonale e Ujësjellës-Kanalizimeve, sha, Sarandë, zgjidhjen e çështjes së prezantuar, për arritjen e standardit dhe normave kombëtare për përfitimin e shërbimeve bazë nga ana e ankuesit si dhe mbrojtjen e mjedisit në zonën ku ankuesi ka vendbanimin.

Referuar parashikimeve të nenit 23, pika 2 të ligjit nr. 139/2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"*, të ndryshuar, Bashkia Sarandë, është përgjegjëse në territorin e juridiksionit të vetë, për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, dhe se në kuptim dhe zbatim të nenit 30, paragrafi 6, të ligjit në fjalë, qeverisja qendrore garanton njësive të vetëqeverisjes vendore, mbështetjen e nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.

Për sa më sipër, për të gjitha arsyet që parashtruam, bazuar në nenin 63, paragrafi 3 të Kushtetutës ku parashikohet se: *"Avokati i Popullit ka drejtë të bëjë rekomandimet dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga Administrata Publike..."*, si dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr.8454/1999 *"Për Avokatin e Popullit"*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *"Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive"*:

REKOMANDOJMË

1. *Bashkia Sarandë, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e këtij rekomandimi, t'i vërë në dispozicion Shoqërisë "Ujësjellës-Kanalizime" sh.a. Sarandë, shtetasit N.B. dhe Avokatit të Popullit informacion të plotë dhe shterues me shkrim që përmban:*

   a) statusin e pronësisë së sipërfaqes së tokës objekt të çështjes;
   b) kufijtë pronësorë sipas dokumenteve urbanistike në fuqi;
   c) statusin e ligjshmërisë së rrethimeve ekzistuese mbi këtë sipërfaqe.

2. *Bashkia Sarandë, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e këtij rekomandimi, të verifikojë në terren situatën faktike të sipërfaqes objekt të çështjes dhe të nxjerrë një akt-konstatimi të pengesave faktike, duke ia komunikuar atë me shkrim shtetasit N.B., Shoqërisë "Ujësjellës-Kanalizime" sh.a. Sarandë, si edhe duke dërguar kopje pranë Avokatit të Popullit.*

3. *Bashkia Sarandë, brenda 10 ditëve nga nxjerrja e aktit të konstatimit, të nxjerrë një vendim formal të arsyetuar për heqjen e pengesave faktike, duke ia komunikuar atë me shkrim shtetasit N.B., Shoqërisë "Ujësjellës-Kanalizime" sh.a. Sarandë, si edhe duke dërguar kopje pranë Avokatit të Popullit.*

4. *Shoqëria "Ujësjellës-Kanalizime" sh.a., brenda 30 ditëve nga vendimmarrja e Bashkisë Sarandë për heqjen e pengesave faktike, të kryejë lidhjen me rrjetin publik të kanalizimeve për pronën e shtetasit N.B. dhe të njoftojë me shkrim Avokatin e Popullit për përfundimin e procesit.*

Në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999 *"Për Avokatin e Popullit"*, të ndryshuar, ju lutemi të na ktheni përgjigje me shkrim brenda 30 ditëve nga marrja e këtij rekomandimi, duke njoftuar masat e marra për zbatimin e tij.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERE

Erinda MELI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AVOKATI I POPULLIT